



PËRPPJEKJA E PRESIDENTES PËR TA ZGJIDHUR NGËRÇIN POLITIK

FAQE 4



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takime të veçanta kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, liderin e PDK-së, Memli Krasniqi, atë të LDK-së, Lumir Abdixhiku, dhe liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj, për të diskutuar

për mundësitë për dalje nga kriza institucionale. Pas takimit, Kurti ka theksuar do të bëjnë çmos që në frymën e bashkëpunimit ta konstituojnë Kuvendin, pastaj qeverinë. Ndërkaq Krasniqi ka thënë se Kosova ka nevojë urgjente për

institucione funksionale, fuqiplota dhe legjitime. E Abdixhiku ka thënë se pozicioni i LDK-së është i njëjti dhe se aktgjykimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese e ka bërë të qartë mënyrën e votimit për zgjedhjen e kryeparlamentarit

SBASHK-U PARALAJMËRON SE SHTATORI MUND TË NISË ME GREVË TË PËRGJITHSHME

F. 3



UP HAP KONKURSION PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË NIVELIN BACHELOR DHE MASTER

F. 3



NË RAHOVEC PO VAZHDOJNË KORRJE-SHIRJET

F. 8

KRYETARI I AKB-SË: USAID-I LARGOHET, POR GJURMËT E TIJ MBETEN NË THEMELET E ZHVILLIMIT TË KOSOVËS

F. 8

SPORT



BATATINA: DO TË LUFTOJMË PËR ÇDO TROFE

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Irani pezullon bashkëpunimin me inspektorët e huaj bërthamorë

TEHRAN, 2 KORRIK - Irani e pezulloi përkohësisht bashkëpunimin me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore (IAEA). Presidenti Masoud Pezeshkian e nënshkroi legjislacionin përkatës, raportoi të mërkurën agjencia e lajmeve “Tasnim”. Vendimi do të thotë se Irani nuk do t’i lejojë inspektorët e IAEA-s të hyjnë në vend derisa të garantohet “siguria” e objekteve të tij bërthamore. Që kjo të ndodhë, organizata me seli në Vjenë duhet t’i dënojë sulmet e ShBA-së dhe Izraelit ndaj objekteve bërthamore të Iranit dhe ta pranojë programin

bërthamor iranian, tha më herët kryetari i Parlamentit të Iranit, Mohammad Bagher Ghalibaf. Shumë detaje të rregullores së re mbeten ende të paqarta. Sipas një zëdhënësi të Ministrisë së Jashtme të Iranit, inspektorët bërthamorë të IAEA-s janë ende në këtë vend. Megjithatë, atyre nuk u lejohet qasja në objektet bërthamore, të dëmtuara nga sulmet e Izraelit dhe të ShBA-së. Më 13 qershor Izraeli nisi një fushatë të madhe bombardimesh kundër Iranit për ta penguar, siç tha, krijimin e armës bërthamore. Irani, i cili mohon se ka ambicie të tilla, u përgjigj me sulme me



raketa dhe dronë kundër qershor, aleatja e Izraelit, ShBA-ja, kreu sulmet kundër objekteve bërthamore iraniane Izraelit. Disa ditë më vonë, më 22

në Fordo, Isfahan dhe Natanz. Sipas autoriteteve në Iran, mbi 900 njerëz humbën jetën në konfliktin 12-ditësh. Sulmet hakmarrëse të Iranit vranë 28 persona në Izrael, sipas autoriteteve atje. Presidenti amerikan Donald Trump tha se sulmet e ShBA-së kanë “shkatërruar” programin bërthamor të Iranit, megjithëse shkalla e dëmit nuk është e qartë. Ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araghchi, pranoi se në objektet bërthamore ka dëme “serioze”. Aktualisht në fuqi është një armëpushim mes Izraelit dhe Iranit.

Trumpi i bën thirrje Hamasit ta pranojë propozimin për armëpushim 60-ditor

UASHINGTON, 2 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, u bëri thirrje militantëve të Hamasit - grup i shpallur terrorist nga ShBA-ja dhe fuqi të tjera - që të bien dakord me atë që e cilësoi si “propozim përfundimtar” për armëpushim 60-ditor me Izraelin në Gazë. “Shpresoj, për të mirën e Lindjes së Mesme, që Hamasi ta pranojë këtë marrëveshje, sepse nuk do të bëhet më mirë - vetëm do të përkeqësohet”, shkroi Trumpi në platformën sociale “Truth Social”. Ai shtoi se Izraeli është pajtuar me kushtet për ta finalizuar armëpushimin 60-ditor, gjatë të cilit, siç tha, “ne do të punojmë me të gjitha palët për t’i dhënë fund luftës”. Trumpi tha se propozimi do t’i dorëzohet Hamasit nga përfaqësues të Katarit dhe Egjiptit. Sipas tij, propozimi doli pas një takimi “të gjatë dhe

produktiv” në lidhje me Gazën, midis përfaqësuesve të tij dhe zyrtarëve izraelitë. Ai nuk i identifikoi përfaqësuesit e tij, por i dërguari i posaçëm i ShBA-së, Steve Witkoff, sekretari i Shtetit, Marco Rubio, dhe zëvendëspresidenti JD Vance duhej të takoheshin më 1 korrik me Ron Dermerin, këshilltar i lartë i kryeministrit izraelit, Benjamin Netanyahu, në Uashington. Zëdhënësjë e Shtëpisë së Bardhë, Karoline Leavitt, tha më 30 qershor se Trumpi dhe zyrtarët e administratës janë në komunikim të vazhdueshëm me udhëheqjen izraelite dhe se përfundimi i konfliktit në Gazë është përparësi për presidentin. “Është rrëqethëse t’i shohësh pamjet që kanë dalë nga Izraeli dhe Gaza gjatë kësaj lufte, dhe presidenti dëshiron që ajo të përfundojë. Ai dëshiron të shpëtojë jetë”, tha Leavitt.



Propozimi i ShBA-së kërkon gjithashtu lirim të gjysmës së pengjeve nga Hamasi në këmbim të të burgosurve palestinezë dhe mbetjeve mortore të palestinezëve të tjerë. Trumpi u tha gazetarëve më herët se shpreson që marrëveshja për pengjet të arrihet javën e ardhshme midis Izraelit dhe militantëve të

Hamasit në Gazë. Ai do të takohet me Netanyahun në Shtëpinë e Bardhë më 7 korrik. Trumpi u tha gazetarëve se do të jetë “shumë i prerë” me Netanyahun për nevojën e një armëpushimi të menjëhershëm në Gazë, duke shtuar se edhe vetë Netanyahu dëshiron që lufta të ndalet. “Shpresojmë që

kjo të ndodhë. Mezi presim që kjo të ndodhë javën tjetër. Duam t’i nxjerrim pengjet”, tha Trumpi. Vizita e Netanyahut në Shtëpinë e Bardhë do të jetë e treta e tij qëkur Trumpi u rikthye në detyrë në muajin janar. Kjo vizitë vjen pas vendimit të Trumpit për t’u bashkuar me luftën e Izraelit kundër Iranit, duke sulmuar centralet bërthamore iraniane. Pasi ndërmjetësoi një armëpushim mes këtyre dy vendeve, Trumpi sinjalizoi se tani është duke e përqendruar vëmendjen te përpjekjet për t’u dhënë fund luftimeve në mes të Izraelit dhe Hamasit. Hamasi tha se është i gatshëm t’i lirojë pengjet e mbetura në Gazë në kuadër të çdo marrëveshjeje për t’i dhënë fund luftës ndërsa, sipas Izraelit, lufta mund të përfundojë vetëm nëse Hamasi çarmatoset dhe shpërbëhet.

Spanja dhe Anglia regjistruan qershorin më të nxehtë ndonjëherë

MADRID, 2 KORRIK - Spanja dhe Anglia regjistruan qershorin e tyre më të nxehtë ndonjëherë, ndërsa vala e nxehtësisë vazhdon të përhapet nëpër Evropë. Shërbimi meteorologjik i Spanjës, Aemet, tha se qershori “jashtëzakonisht i nxehtë” - me një temperaturë mesatare prej 23.6 gradësh celsius - “ka shënuar rekorde”, duke tejkaluar mesataren normale për korrikun dhe gushtin. Në Angli, Zyra Meteorologjike tha se temperatura mesatare e qershorit prej 16.9 gradësh celsius vendosi një rekord të ri për atë muaj, ndërsa Mbretëria e Bashkuar - në tërësi - regjistroi

qershorin e dytë më të nxehtë që nga fillimi i matjeve në vitin 1884. Portugalia kontinentale regjistroi, gjithashtu, një temperaturë rekorde ditore në qershor - prej 46.6 gradësh celsius. Të dhënat mesatare mujore nuk janë publikuar ende. Në Turqi zjarret detyruan dhjetëra mijëra njerëz të evakuoheshin, ndërsa në Itali dy persona humbën jetën për arsye që lidheshin me nxehtësinë. Në Francë vala e të nxehtit vazhdoi në pjesën më të madhe të vendit edhe të martën - një ditë pasi shumë qytete përjetuan natën dhe ditën më të nxehtë të regjistruar ndonjëherë në qershor.

Maja e Kullës Eiffel në Paris u mbyll për shkak të nxehtit, ndërsa ministrja franceze e Klimës, Agnes Pannier-Runacher, e përshkroi këtë si një situatë “të paparë”. Për herë të parë në pesë vjet rajoni i Parisit e aktivizoi alarmin e kuq - që është paralajmërimi më i lartë për nxehtësinë ekstreme - së bashku me 15 rajone të tjera franceze. Në Itali, rajoni i Toskanës, shënoi rritje për 20 për qind të pranimeve në spital për shkak të problemeve që lidhen me nxehtësinë. Rajoni i Ballkanit, po ashtu, është përfshirë nga temperaturat e larta.



UP hap konkursin për pranimin e studentëve në nivelin bachelor dhe master

PRISHTINË, 2 KORRIK - Universiteti i Prishtinës ka hapur konkursin për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve në nivelin bachelor dhe master për vitin akademik 2025/2026. UP-ja pritet t'i pranojë 5 723 studentë të rregullt në nivelin bachelor, kurse 2 394 studentë në nivelin master, prej të cilëve 9 studentë ndërkombëtarë. Të dy konkurset për pranimin e studentëve janë hapur për 14 njësitë akademike të UP-së. Sipas njoftimit të UP-së, programet e studimit të ofruara nga ky universitet mbulojnë fusha të ndryshme studimi dhe janë të ndërtuara për t'i përgatitur studentët për sfidat e tregut të punës, duke i pajisur ata me njohuri dhe aftësi të nevojshme për zhvillim profesional dhe personal. “Universiteti i Prishtinës synon të krijojë një ambient të favorshëm akademik, ku studentët mund të rriten në aspektin intelektual dhe të arrijnë objektivat e tyre në karrierë. Ftoheni të aplikoni dhe të bëheni pjesë e një universiteti me histori, traditë dhe përkushtim ndaj cilësisë në arsim”, thuhet në njoftimin e UP-së. Aplikimi për studentët në studimet e nivelit bachelor në platformën online do të jetë i hapur nga data 30.06.2025 deri më 08.07.2025, kurse për studentët në studimet e nivelit master do të jetë i hapur më 30.06.2025 deri më 11.07.2025.



SBASHK-u PARALAJMËRON SE SHTATORI MUND TË NISË ME GREVË TË PËRGJITHSHME



EPOKA ERE **Faton DËRAMKU**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka bërë me dije se po përgatitet për thirrjen e një kongresi të jashtëzakonshëm, me karakter vendimmarrës, për t'i përcaktuar veprimet sindikale në rast se vazhdon boshllëku institucional dhe mungesa e dialogut me

autoritetet qendrore. Në një komunikatë për medie, SBASHK-u thekson se “në takimet e shpeshta me udhëheqësit sindikalë nga të gjitha nivelet e arsimit, ka analizuar me kujdes situatën aktuale politike dhe institucionale në vend”. Sipas kësaj komunikate, gjatë këtyre analizave janë shprehur “kritika të argumentuara ndaj partisë që doli e para në zgjedhjet e shkurtit”, të cilën e akuzon se

po injoron vullnetin e qytetarëve dhe po lë anash prioritetet reale të vendit, përfshirë edhe interesat e punëtorëve të arsimit. SBASHK-u shpreh shqetësimin se, për shkak të mungesës së institucioneve funksionale, “nuk ka se kujt t'i adresohen kërkesat e punëtorëve arsimorë”, duke e cilësuar këtë si një boshllëk serioz institucional. Në këtë kontekst, sindikata ka shtuar kontaktet me

strukturat sindikale në gjithë vendin, nga çerdhet deri tek universitetet. “Unanimisht është vendosur që të nisin përgatitjet për mbajtjen e një Kongresi të jashtëzakonshëm. Ky kongres do të ketë karakter vendimmarrës për veprime të mëtejshme sindikale. Në të do të shqyrtohet dhe vendoset qartë nëse muaji shtator do të shënojë fillimin e vitit të ri shkollor, apo do të jetë fillimi i veprimeve sindikale, duke mos

përfshirë grevën e përgjithshme në tërë sistemin arsimor të Kosovës”, thuhet në komunikatën e SBASHK-ut. Sindikata shton se mbetet e përkushtuar për t'i mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e punëtorëve të arsimit, ndërsa u bënë thirrje institucioneve përgjegjëse “të veprojnë me përgjegjësi, t'i hapin rrugë dialogut dhe të japin zgjidhje konkrete për kërkesat e punëtorëve arsimorë”.

Ambasada e ShBA-së në Kosovë feston Ditën e Pavarësisë, Prattipati e quan Kosovën vendin më proamerikan në botë

PRISHTINË, 2 KORRIK - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë ka organizuar pritje për nder të 249-vjetorit të Pavarësisë së ShBA-së. Në një atmosferë festive dhe miqësore, përfaqësues të institucioneve të Kosovës, trupit diplomatik dhe shoqërisë civile, morën pjesë për të shënuar këtë ditë të rëndësishme për popullin amerikan. Në fjalimin e saj përshëndetës, zëvendës shefja e ambasadës së ShBA-së në Prishtinë, Anu Prattipati, ka theksuar lidhjet e veçanta mes dy vendeve dhe vlerësuar mikpritjen e ngrohtë të popullit të Kosovës. “Kam festuar 4 Korrikun në shumë vende të ndryshme, dhe nuk mund të imagjinoj një vend më të mirë për ta shënuar këtë rast sesa këtu, me ju, në vendin më pro-amerikan në botë. Faleminderit që po festoni me ne sonte! Faleminderit për miqësinë tuaj dhe përkushtimin tuaj ndaj partneritetit ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës! Gëzuar Ditën e Pavarësisë!”, ka theksuar Prattipati.





PËRPPJEKJA E PRESIDENTES PËR TA ZGJIDHUR NGËRÇIN POLITIK

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takime të veçanta kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, liderin e PDK-së, Memli Krasniqi, atë të LDK-së, Lumir Abdixhiku, dhe liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj, për të diskutuar për mundësitë për dalje nga kriza institucionale. Pas takimit Kurti ka theksuar do të bëjnë çmos që në frymën e bashkëpunimit ta konstituojnë Kuvendin, pastaj qeverinë. Ndërkaq Krasniqi ka thënë se Kosova ka nevojë urgjente për institucione funksionale, fuqiplota dhe legjitime. E Abdixhiku ka thënë se pozicioni i LDK-së është i njëjti dhe se aktgjykimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese e ka bërë të qartë mënyrën e votimit për zgjedhjen e kryeparlamentarit

Gjykatës Kushtetuese. Ai ka theksuar se në javën e fundit të korrikut duhet ta konstituojmë legjislaturën e nëntë. “Afatet po rrjedhin. Në javën e fundit të korrikut duhet që ta konstituojmë legjislaturën e nëntë. Do të bëjmë çmos që në frymën e bashkëpunimit, me konsultime të dendra dhe konstruktive dhe gjithashtu me idenë e konsensusit apo kompromisit ta realizojmë këtë gjë, në mënyrë që më pastaj të kalojmë te formimi i qeverisë së re që i përgjigjet kuvendit të ri të Republikës. Znj. Presidente gjatë ditës do të ketë takime edhe me përfaqësues të partive të tjera politike dhe mbase në fund mund të shohim se a kemi bërë përparim, sa kemi bërë përparim dhe sa është i mjaftueshëm një përparim i tillë. Le t'i japim shansin edhe takimeve tjera deri në fund për të parë se cili është progresi për të cilin jemi të interesuar të gjithë”, ka thënë Kurti. Osmani pas Kurtit ka takuar edhe liderin e PDK-së, Memli Krasniqi, i cili për medie tha se në takimin me presidenten Vjosa Osmani, rikonfirmoi gatishmërinë e Partisë Demokratike të Kosovës për të kontribuar në tejkalimin e bllokadës për konstituimin e

Kuvendit. “Tashmë me një interpretim të qartë kushtetues mbi kompetencat dhe përgjegjësitë institucionale të secilit akter. Si PDK, kemi paraqitur qëndrime të qarta dhe propozime konkrete për të rikthyer funksionalitetin institucional dhe respektin ndaj rendit demokratik. Bashkëpunimi dhe kompromisi mbeten parimet tona udhërrëfyese - të konfirmuara qartë edhe në aktgjykimin e fundit të Gjykatës Kushtetuese. Shpresojmë që këto konsultime të sjellin reflektim, tejkalim të kryeneçësisë politike dhe rikthim të rregullorja, ligji dhe Kushtetuta. Kosova ka nevojë urgjente për institucione funksionale, fuqiplota dhe legjitime. Nuk kemi pse të presim afatin kushtetues 30-ditor për konstituimin e Kuvendit - mund dhe duhet ta bëjmë qysh nesër, në mënyrën e duhur. Ndryshe - Kushtetuesja do të jetë përsëri adresa për të konfirmuar pengmarrjen institucionale të shtetit!”, ka thënë Krasniqi. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka folur pas takimit me presidenten Vjosa Osmani. Ai tha se pozicioni i LDK-së është

i njëjti dhe thotë se aktgjykimi i fundit i Gjykatës Kushtetuese e ka bërë të qartë mënyrën e votimit për zgjedhjen e kryeparlamentarit, derisa tha se përgjegjësia i takon të parit. “E dini pozicionin tonë të LDK-së rreth çështjes aktuale të konstituimit të institucioneve. Ne kemi një aktgjykim që është i qartë për mënyrën e votimit dhe mbi të gjitha është i qartë sa i përket thelbit të problemit. E thelbi është që i takon partisë së parë, Grupit Parlamentar më të madh që të propozojë dhe njëkohësisht të krijojë shumicë parlamentare. Praktikat e deritanishme janë shumë të qarta”, ka thënë Abdixhiku. Ai ka theksuar se LDK-ja nuk ka çështje të emrave sa i përket kryekuvendarit dhe se do të votojë kundër çdo propozimi të Vetëvendosjes. Ndërkaq për kryesuesin e seancës, Avni Dehari, ka thënë se me veprim arbitrar dhe pa respektuar asnjë procedurë vendosi që të kalojë në votim të fshehtë kundër Kushtetutës. “Le të presim takime të tjera. Ftojme për konsensus dhe unitet. Duhet të kërkojmë shumicë politike siç ka qenë”, është shprehur ai. Abdixhiku ka thënë se takimet janë të mirëseardhura.

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 2 KORRIK - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, të mërkurën ka takuar ndaras përfaqësuesit e partive politike, në përppjekje për ta zgjidhur krizën institucionale në vend. Përkundër plot 40 përppjekjeve, deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Kosovës nuk kanë arritur ende ta konstituojnë institucionin ligjvënës. Zgjedhjet parlamentare janë mbajtur më 9 shkurt.

Me një vendim të lëshuar javën e kaluar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka urdhëruar konstituimin e Kuvendit brenda 30 ditësh. Që nga aktgjykimi janë mbajtur edhe dy seanca në Kuvend, por pa rezultat. Përfaqësuesit e partive politike fajësojnë njëri-tjetrin për mungesë përgjegjësie. Pas takimit, Kurti ka folur për medie. Ai tha se bashkë me Osmanin diskutuan gjerë e gjatë lidhur me konstituimin e Kuvendit të Republikës në dritën e aktgjykimit të fundit të



“Përfshirja e presidentes është e mirëseardhur. Ajo fundja e fundit është garantuese e funksionimit demokratik të institucioneve. Kosovës s’po i funksionon institucioni kryesor demokratik që është Kuvendi dhe më pas Qeveria. Kurti është duke qeverisur me rezultat të para katër viteve. Pra, i ka pasur 50 % para katër viteve, prandaj ka qenë kryeministër dhe tashmë s’i ka dhe meqenëse se nuk i ka nuk ka legjitimitet, e besa as moral politik se si mund të mbash një detyrë kur s’e do populli”, ka thënë Abdixhiku.

Presidentja Vjosa Osmani të mërkurën e ka pritur në takim edhe liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar për të 40-n herë me radhë që ta konstituojnë

përbërjen parlamentare të dalë nga zgjedhjet e 9 shkurtit. Më 1 korrik u shënua hera e tretë që deputetët nuk arritën kurrfarë progresi në konstituimin e Kuvendit që nga shpallja e një aktgjykimi nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, e cila më 26 qershor obligoi deputetët që brenda 30 ditësh ta konstituojnë Kuvendin - afat që skadon më 26 korrik.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nisma Socialdemokrate, si dhe Lista Serbe, që nga 1 maji po refuzojnë të propozojnë anëtarë për një komision që do të mbikëqyrte një votim të fshehtë për kryeparlamentarin e ri.

Pas aktgjykimit të Kushtetueses, kreu i LV-së, Albin Kurti, ftoi në

takim krerët e partive politike, por edhe pas dy orësh takim ata nuk arritën një marrëveshje për të dalë nga ngërçi. Kurti tha se ka ofruar kompromise, por partitë që mandatin e kaluar ishin në opozitë thanë se takimi i ftuar nga ai ishte “farsë”, duke shtuar se kreu i partisë fituese të zgjedhjeve po insiston në pozicionet paraprake.

LV-ja, si parti fituese, e ka të drejtën ekskluzive që ta propozojë kandidatin për kryeparlamentar.

Deri më tani ky subjekt ka propozuar për këtë post Albulena Haxhiun - që PDK-ja dhe AAK-ja e kanë cilësuar si figurë përçarëse.

Pas aktgjykimit të Kushtetueses, Haxhiu ka deklaruar se do të tërhiqet nga kandidatura nëse në votim të fshehtë nuk merr

61 votat e nevojshme.


Që Kuvendi të konsiderohet i konstituuar duhet të zgjidhet kryetari dhe pesë nënkryetarët. Vetëm pas kësaj, nisin afatet për formimin e Qeverisë së re të Kosovës.

Arifi: Pa koalicion e pa kompromise nuk do të lëvizë asgjë

Politologu nga Prishtina, Dritëro Arifi, tha për “Radion Evropa e Lirë” se këto takime janë pozitive por rezultati, sipas tij, pritet të jetë i dobët, “për shkak se partitë janë fragmentalizuar në qëndrimet e veta dhe nuk po lëvizin fare nga pika A në pikën B. Mbetet të shihet nëse janë të gatshme për ndonjë kompromis apo jo. Kjo është një pikëpyetje shumë

e madhe, të cilën presidentja nuk ka fuqi që t’ua imponojë partive politike apo koalicioneve. Po vërehet se pa koalicione e pa kompromise nuk do të lëvizë asgjë. E gjuha e partive politike nuk është e përafërt me atë që ne po flasim”, tha Arifi. Sipas tij, presidentja është vonuar pak me këto takime, pasi Kosova po hyn në muajin e pestë pa institucione. Ai shtoi se nuk dihet se çfarë do të ndodhë as pas 26 korrikut, kur skadon afati i dhënë nga Gjykata Kushtetuese për konstituimin e Kuvendit.

Sipas Arifit, vendi është duke shkuar në zgjedhje të jashtëzakonshme dhe çështja është vetëm kur do të bien dakord partitë për datën e tyre - para apo pas zgjedhjeve lokale të tetorit.



Komuna e Prishtinës organizon testimin për plotësimin e kuadrit arsimor

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kryeqyteti ka organizuar testimin për kandidatët që janë në procedura të rekrutimit në kuadër të konkursit për IEAA për ta shtyrë tutje edhe më tepër plotësimin e stafit për të vijuar me mësimin tërëditor. “Po zhvillohemi çdo vit më tepër, duke krijuar mundësi

më të mira për nxënësit dhe stafin e angazhuar në kuadër të institucioneve arsimore. Kur e filluam mësimin tërëditor, shumë hezitan për rrugën që kryeqyteti ka nisur, po vazhdojmë edhe tani me plotësimin e kuadrit arsimor në këtë drejtim. Falënderojmë

Burimet Njerëzore dhe drejtorin e Arsimit të kryeqytetit që me transparencë maksimale kanë menaxhuar këtë proces të ndjeshëm, duke dëshmuar se krahas vullnetit për zhvillimin e arsimit në kryeqytet, po e ngrisin transparencën çdo vit”, ka njoftuar komuna e Prishtinës.



PËRURORHET OBJEKTI I RI I BIBLIOTEKËS SË QYTETIT “LATIF BERISHA” NË MITROVICË



MITROVICË, 2 KORRIK - Në Mitrovicë është mbajtur ceremonia solemne e përrurimit të objektit të ri të bibliotekës së qytetit, që mban emrin e intelektualit dhe veprimtarit të shquar Latif Berisha. Ky objekt modern synon t'i plotësojë nevojat e lexuesve, studentëve dhe të gjithë dashamirëve të librit në qytet. Në këtë ngjarje morën pjesë kryetari i komunës Bedri Hamza, nënkryetari Arian Tahiri, kryesuesja e Kuvendit Komunal, Vesa Broja, drejtorë komunalë, asamblistë, intelektualë, veprimtarë,

përfaqësues të familjes Berisha, si dhe qytetarë të shumtë. Kryetari Hamza, në fjalën e tij përshëndetëse, theksoi rëndësinë që ky institucion do të ketë për qytetin. “Sot Mitrovicës po i shtohet një objekt i veçantë, që mban emrin e një personaliteti të madh kombëtar e kulturor, Latif Berisha. Investimi në dije dhe në ngritjen e gjeneratave të reja nuk është shpenzim, por është investimi më i duhur. Jam i bindur që në këtë objekt që po e përrurojmë sot do të kalojnë shumë nxënës, studentë, intelektual, shkrimtarë dhe dashamirë të librit”.

Ndërkaq nënkryetari Arian Tahiri u shpreh se kjo ditë është e mrekullueshme për Mitrovicën. “Biblioteka që prej dekadash nuk kishte objekt të qëndrueshëm, sot më në fund ka shtëpinë e saj të re - një hapësirë moderne në shërbim të dijes. Le ta gëzojnë nxënësit, studentët, dashamirët e librit si dhe e gjithë Mitrovica”. Në ceremoni u mbajtën edhe fjalime nga poetë dhe intelektualë të pranishëm, të cilët vlerësuan lart kontributin e Latif Berishës dhe rolin që do të ketë kjo bibliotekë në jetën kulturore dhe arsimore të qytetit.

TËRNASA TAKON KRYETARËT E KËSHILLAVE TË BIK-UT, DISKUTOJNË PËR JETESËN FETARE NË KOSOVË

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, ka mbajtur të mërkurën një takim me kryetarët e Këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës, me të cilët ka diskutuar për një sërë çështjesh me rëndësi, përfshirë këtu gjendjen aktuale të jetës fetare në Kosovë dhe mbarëvajtjen e saj. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për organizimin dhe mbarëvajtjen e haxhit për këtë vit, si dhe për ecurinë e organizimit të therjes së kurbaneve. Myftiu Naim ef. Tërnavë vlerësoi kontributin e Këshillave në ruajtjen e unitetit dhe zhvillimin e aktiviteteve fetare në nivel kombëtar. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë në mes të Këshillave



dhe Kryesisë për t'u përballur me sfidat aktuale dhe për t'i përmbushur nevojat shpirtërore të besimtarëve. Kjo mbledhje shërbeu për angazhimin e Bashkësisë

Islame të Kosovës për të adresuar çështje të ndryshme që ballafaqohen me organizmin e jetës fetare dhe iniciativat për të ndihmuar shoqërinë.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR HAPJEN E PUSEVE

PODUJEVË, 2 KORRIK - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me drejtorin e Organizatës “Qatar Charity” në Kosovë, Esam Dabab, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për hapjen e puseve të ujit për pije për familjet me kushte të rënda ekonomike. Sipas kësaj marrëveshje, Organizata “Qatar Charity” do të financojë 90 për qind të projektit, kurse komuna e Podujevës do të participojë me 10 për qind të shumës së përgjithshme. Kryetari Bulliqi e ka falënderuar Dabab për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që komuna e Podujevës ka me Organizatën “Qatar Charity” për realizimin e shumë projekteve që ndikojnë në të mirë të qytetarëve të



komunës sonë. Gjatë këtij takimi ishte edhe drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Adelina Stublla dhe menaxheri i programeve në Organizatën “Qatar Charity”, Ahmed al Ashaal.

Ambasadori i Shqipërisë viziton muzeun “Çast” në zyrat e Fondacionit “Jahjaga”

PRISHTINË, 2 KORRIK - Ambasadori i Shqipërisë, Petrit Malaj, ka vizituar muzeun “Çast” në zyrat e Fondacionit “Jahjaga”. “Patëm nderin dhe kënaqësinë të mirëpresim për vizitë Ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë z. Petrit Malaj në muzeun ‘Çast’ dhe në zyrat e

Fondacionit Jahjaga. Gjatë vizitës, ambasadori Malaj u njoh nga afër me punën e Fondacionit Jahjaga si dhe vizitoi muzeun ‘Çast’ një hapësirë që ruan kujtesën dhe rrëfimet e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Diskutuam për mundësitë e bashkëpunimit

në të ardhmen, me synim forcimin e përpjekjeve të përbashkëta për interesat e përgjithshme të qytetarëve tanë. Të faleminderit shumë miku im, ambasador Malaj për kohën dhe vizitën e çmuar”, ka njoftuar ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga.



PDK-ja vlerëson jashtëzakonisht bashkëpunimin me NDI-në

PRISHTINË, 2 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i shoqëruar nga sekretarja e përgjithshme, Vlora Çitaku dhe nënkryetarja Besianë Musmurati, ka pritur në takim drejtoreshën e NDI në Kosovë, Nancy Soderberg. Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin e deritanishëm dhe mundësitë për thellimin e mëtejme të tij - në funksion të gjithëpërfshirjes

dhe fuqizimit të grave dhe të rinjve në jetën politike dhe institucionale të vendit. Në njoftimin për medie, Partia Demokratike e Kosovës ka dëshmuar në vazhdimësi se të rinjtë dhe gratë janë pjesë themelore e organizimit dhe vendimmarrjes politike, gjë që reflektohet qartë si në përfaqësimin në strukturat udhëheqëse, ashtu edhe në listat për deputetë dhe

asamble komunale. “Të dyja palët shprehën gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimin e ngushtë edhe gjatë gjithë procesit të zgjedhjeve lokale, me qëllim të përfaqësimit të barabartë. PDK e vlerëson jashtëzakonisht bashkëpunimin me NDI-në dhe mbetet e përkushtuar për ta çuar këtë partneritet në një nivel edhe më të lartë”, ka njoftuar PDK-ja.



2 KORRIKU I VITIT 1990 HODHI THEMELET E REPUBLIKËS

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 KORRIK - Të mërkurën janë mbushur 35 vjet që kur delegatët e atëhershëm të Kuvendit të Kosovës miratuan Deklaratën Kushtetuese të 2 Korrikut. Në këtë ditë historike Kosova është shpallur njësi e veçantë në kuadër të federatës së atëhershme jugosllave.

Deklarata e 2 Korrikut 1990 ishte akti që do ta shënojë hapin historik institucional të pavarësisht të Kosovës i cili u zhvillua jashtë objektit të Kuvendit në kushte të rrethimit nga forca të mëdha policore e ushtarake të Serbisë.

Deklaratën Kushtetuese mbi Kosovën si njësi të pavarur dhe të barabartë në kuadër të federatës apo konfederatës jugosllave, e shpallën në Prishtinë 114 delegatët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se 2 Korriku i vitit 1990 është dita kur u hodhën themelet e Republikës. “Sot kujtojmë me krenari Deklaratën Kushtetuese të 2 Korrikut, të shpallur nga 114 delegatë të Kuvendit të Kosovës para dyerve të këtij institucioni të mbyllura dhunshëm nga regjimi kriminal i Serbisë. Me këtë akt historik, i cili i parapriu Kushtetutës së Kaçanikut më 7 shtator, gra e burra, sfiduan regjimin dhe i dhanë zë vullnetit të popullit për Kosovën Republikë, duke e hapur rrugën drejt pavarësisht dhe lirisë. Kjo ditë guximi dhe vizioni mbetet



themel i shtetësisë sonë. Nderim i përhershëm për delegatët e 2 Korrikut, trasuesit e ëndrrës për Kosovën e lirë dhe sovranë”, ka thënë Osmani.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka kujtuar 35-vjetorin e miratimit të Deklaratës Kushtetuese për Kosovën, duke e cilësuar si një nga momentet më të rëndësishme dhe historike në rrugëtimin politik të popullit drejt lirisë dhe shtetësisë. “Kjo deklaratë, e mbështetur në parimet universale të barazisë, lirisë dhe demokracisë, i parapriu hartimit të Kushtetutës së Kaçanikut dhe shënoi një

pikënisje të rëndësishme për proceset e mëtejme të shtetformimit dhe ndërtimit institucional të Republikës së Kosovës. Respekt dhe mirënjohje për delegatët, të cilët me guxim dhe pjekuri politike, shpallën Kosovën njësi të pavarur dhe të barabartë me republikat tjera të ish-Jugosllavisë, pavarësisht rrethanave të vështira dhe pranisë së forcave policore serbe që kishin rrethuar ndërtesën e Kuvendit ku po zhvillohej kjo ngjarje historike”, është thënë në komunikatën e PDK-së.

Këtë përvjetor të Deklaratës

Kushtetuese të 2 Korrikut e ka kujtuar edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). “Sot shënojmë 35-vjetorin e shpalljes së Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990, aktin historik që hodhi themelet juridike dhe politike të shtetësisë së Kosovës. Në rrethana jashtëzakonisht të vështira, nën rrethim ushtarak dhe presion të ashpër nga regjimi serb, 114 delegatë të Kuvendit të atëhershëm të Kosovës e shpallën Kosovën si njësi të barabartë dhe të pavarur brenda federatës së asaj kohe, duke shprehur qartë vullnetin e palëkundur të

popullit për liri, pavarësi dhe demokraci. Ky akt i guximshëm, i cili sfidoi sistemin shtypës dhe i dha zë aspiratës së kahmotshme për liri, u shndërrua në pikënisjen e një rruge të re për Kosovën; rrugën drejt pavarësisht së plotë, demokracisë dhe integritetit euroatlantik.

Lëvizja gjithëpopullore e Kosovës, e prirë nga presidenti historik i Kosovës dr. Ibrahim Rugova, unifikoi popullin rreth kësaj kauze, vuri bazat juridike e institucionale të shtetësisë si dhe fitoi përkrahjen e botës demokratike. Këto përpjekje u pasuan nga lufta e çlirimtare e popullit të Kosovës dhe ndërhyrja vendimtare e NATO-s, të cilat sollën përfundimisht lirinë në Kosovë”, është thënë në komunikatën e LDK-së.

Ndërkaq kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se 35 vjet më parë, guximtarët e vizionarët shqiptarë, edhe pse të rrethuar nga tytat e ish-Jugosllavisë, të patrembur kërkuar legjitimen: të drejtën për t'u njohur dhe për të ekzistuar barabartë si të tjerët. “Fillet e Republikës së Kosovës janë nga Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut. Ishin shkëndijat e para se Kosova nuk kishte rrugë tjetër, përpos asaj të mëvetësisë. Sot, me nder dhe krenari, kujtojmë të gjithë atë kastë brilante që nuk u drodhën duart të nënshkruajnë atë deklaratë në rrethana skajshmërisht të tensionuara. Mirënjohje të gjithë brezave nga të gjitha trojet që guxuan për Kosovën”, ka thënë Haradinaj.

Më pak çifte të kurorëzuara në vitin 2024 sesa një vit më parë

PRISHTINË, 2 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e kurorëzimeve për vitin 2024. Në vitin 2024 janë regjistruar 17 863 kurorëzime (brenda dhe jashtë Kosovës). Prej këtyre kurorëzimeve të regjistruara, 16 075 kurorëzime kanë ndodhur brenda territorit të Kosovës kurse jashtë Kosovës janë regjistruar gjithsej 1 788

kurorëzime. Krahasuar me vitin 2023, numri i rasteve të kurorëzimeve të regjistruara në total (brenda dhe jashtë Kosovës) në vitin 2024 ishte më i vogël për 630, ose 3,4 %. Numri i rasteve të kurorëzimeve të regjistruara brenda Kosovës në vitin 2024 ishte më i vogël për 903, ose 5,3 % krahasuar me vitin 2023, përderisa numri i rasteve të

kurorëzimeve të regjistruara jashtë Kosovës në vitin 2024 shënoi rritje për 273 ose 18 % krahasuar me vitin 2023. Numri më i madh i rasteve të kurorëzimeve është regjistruar te grupmoshat 25-29 për meshkuj me gjithsej 5 027 kurorëzime, ose 31,3 %, ndërsa te femrat grupmosha 20-24 me gjithsej 4 986 kurorëzime, ose 31 % e rasteve.



Në Rahovec po vazhdojnë korrje-shirjet

RAHOVEC, 2 KORRIK - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me drejtorin e bujqësisë, Berat Duraku, ishin në vizitë te bujku punëtor, Ilir Orllati, në fshatin Brestoc, një shembull i përkushtimit dhe i seriozitetit në bujqësi. Ai kultivon grurë, thekër, tërshërë, jonxhë, vreshta dhe

ka të organizuar edhe një stallë me 120 krerë bagëti. Gjithsej, ka rreth 85 hektarë që janë të mbjella me kultura të ndryshme bujqësore. Gruri, si një kulturë strategjike për vendin tonë, këtë vit sipas informatave nga shtabi komunal për korrje-shirje, pritet të korren rreth 3 500 hektarë të mbjella

me drithëra. “E përgëzoj Ilirin për punën e palodhur dhe jam krenar për të gjithë bujqit tanë që çdo ditë e mbajnë të gjallë bujqësinë në Rahovec. Bujq të veshëm si Iliri ka shumë në komunën tonë, që me mundin e tyre po i japin jetë dhe qëndrueshmëri zhvillimit bujqësor”, ka thënë Latifi.



BE-ja PROPOZON REDUKTIM PREJ 90 % TË GAZRAVE SERRË DERI MË 2040

BRUKSEL, 2 KORRIK - Komisioni Evropian propozoi që deri në vitin 2040 vendet e Bashkimit Evropian ta zvogëlojnë ndotjen nga gazrat serrë për 90 % krahasuar me nivelin që kishin në vitin 1990. BE-ja synon të bëhet neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050 - që do të thotë se nuk do të lëshojë më shumë gazra serrë sesa mund të përthithen nga natyra ose me mjete teknike. Aktualisht, vendet e BE-së duhet ta zvogëlojnë ndotjen që shkakton ndryshime klimatike për 55 % deri në



vitin 2030, krahasuar me nivelin që kishin në vitin 1990. Që kur BE-ja miratoi ligjin për klimën në vitin 2021, kundërshtarët e veprimit klimatik dhe ambicieve mjedisore të bllokut kanë mbledhur forcë, duke argumentuar se masat e pengojnë përparimin ekonomik. “Ne nuk po zgjedhim mes ekonomisë dhe agjendës së gjelbër, po i zgjedhim të dyja. Evropa është e përkushtuar për një tranzicion të drejtë, ambicioz

dhe konkurrues drejt energjisë së gjelbër”, tha nënkryetarja e Komisionit, Teresa Ribera. Projektligji i paraqitur të mërkurën duhet të negociohet nga vendet e BE-së dhe Parlamenti Evropian, përpara se objektivi i ri për klimën të hyjë në fuqi. Me këto plane shtetet anëtare do të kenë më shumë fleksibilitet për të arritur objektivat klimatike. Deri tani ato kanë mundur t'i llogarisin vetëm reduktimet e gazrave serrë në nivel kombëtar.

AUDITORJA E PËRGJITHSHME TAKON PËRFAQËSUESIT E ZYRËS SË BE-së NË KOSOVË, DISKUTOJNË PËR PROCESIN E AUDITIMIT

PRISHTINË, 2 KORRIK - Auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, ka pritur në takim pune udhëheqësen e ekipit të Qeverisjes së Mirë në kuadër të projektit Reforma në Administratën Publike/-Menaxhimi i Financave Publike në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, Laura Fallavollita. Takimi u mbajt në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe pati për qëllim informimin e

dyanshëm për zhvillimet më të fundit. Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, e njoftoi mysafiren për përfundimin e procesit të auditimit të rregullsisë dhe publikimin e raporteve. Në veçanti u bisedua për trendin e opinioneve të auditimit për organizatat buxhetore në nivel qendror dhe lokal si dhe potencoi rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve nga

institucionet publike. Gjithashtu, Spanca e njoftoi edhe për auditimin e Raportit Financiar Vjetor të buxhetit të shtetit dhe për çështje të tjera me interes të dyanshëm. Palët theksuan rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë si dhe rëndësinë që kanë auditimet në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në institucionet publike.



KRYETARI I AKB-së: USAID-i LARGOHET, POR GJURMËT E TIJ MBETEN NË THEMELET E ZHVILLIMIT TË KOSOVËS



PRISHTINË, 2 KORRIK - “Lajmi për mbylljen e USAID-it në Kosovë më prek personalisht dhe profesionalisht. USAID-i nuk ishte vetëm një agjenci ndihme - ishte partneri ynë strategjik në ndërtimin e një Kosove më të mirë”, ka theksuar kryetari i AKB-së, Agim Shahini. Ai ka thënë se për Aleancën Kosovare të Bizneseve kjo ishte një mbështetje themelore në vitin 2002 në ditët tona të para. “Për

mua personalisht, USAID-i më dha mundësinë për aftësim profesional në programe të shumta në ShBA gjatë gjithë kohës, duke formuar rrugën time si lider në shërbim të ekonomisë sonë. Gjatë më shumë se dy dekadave, USAID-i solli në Kosovë investime, dije, partneritete dhe shpresë. Më shumë se 1 miliard dollarë u investuan në drejtësi, arsim, ekonomi dhe demokraci – në

vetë themelet e një shteti të qëndrueshëm. Në emër të AKB-së, të bizneseve dhe qytetarëve që përfituan, them me zemër: Faleminderit USAID-it për çdo mbështetje, çdo program dhe çdo mundësi. Kosova do t’ju kujtojë gjithmonë me mirënjohje. Një derë e madhe mbyllet, një mirënjohje e përjetshme hapet!”, ka theksuar kryetari i AKB-së, Agim Shahini.

Rriten për 3 % remitencat në Kosovë në periudhën janar - maj

PRISHTINË, 2 KORRIK - Të hollat nga diaspora në Kosovë arritën në 530 milionë euro gjatë pesë muajve të parë të vitit 2025, nga 513 milionë euro në të njëjtën periudhë


të vitit të kaluar, bëri me dije Banka Qendrore, duke cituar të dhëna paraprake. Vetëm gjatë muajit maj dërgesat nga jashtë u rritën për 7 % në baza vjetore, duke

kapur shumën prej 126.6 milionë eurosh, thuhet në publikimin e të dhënave të së martës nga Banka Qendrore. Krahasuar me muajin prill,

dërgesat në maj shënuan rritje prej 13 %. Gjatë vitit 2024 dërgesat e huaja në Kosovë ishin rritur me 1.1 %, duke arritur në gjithsej 1.35 miliard euro.



PSE POPULISTËT MAGJEPSËN ME LETËRSINË FANTASTIKE?



Nga: Martin SANDBU / *The Financial Times* [Why is the right so fascinated with fantasy literature?]

Kryeministrja italiane, Giorgia Meloni, themeloi një konferencë politike konservatore të emërtuar sipas një heroi të një romani bestseller të zhanrit të fantazisë, të vitit 1979 [Atreju, personazh nga vepra Historia pa mbarim]; dikur ajo vishte kostumin e hobitit, ndërsa në vitin 2023 organizoi një ekspozitë muzeale kushtuar J.R.R. Tolkienit [autor i Kryezotit të Unazave dhe Hobitit]. Peter Thiel, miliarderi i teknologjisë që mbështet Trumpin dhe është skeptik ndaj demokracisë, kryeson një trend në Luginën e Silikonit [Silicon Valley] për emërtimin e kompanive të frymëzuara nga Kryezoti i Unazave – duke filluar nga kompania e tij e inteligjencës së të dhënave, Palantir (gurë magjikë në Tokën e Mesme), deri te prodhuesi i armëve, Anduril (një shpatë, sipas Tolkienit). Nënpresidenti amerikan, J.D. Vance, ka thënë se konservatorizmi i tij është ndikuar nga Tolkieni dhe C.S. Lewisi – autori i Kronikave të Narnisë. Me fjalë të tjera, magjepsja me letërsinë fantastike i bashkon konservatorët nacionalistë evropianë, sivëllezërit teknologjikë të Trumpit dhe

lëvizjen MAGA [Make America Great Again]. A është kjo thjesht një rastësi? Apo ka diçka në vetë natyrën e letërsisë fantastike që, në mënyrë të pazakontë, përputhet me mendësinë e djathtë? Në rastin italian, adhurimi për letërsinë fantastike ka qenë “më shumë psikologjik sesa politik”, thotë Salvatore Vassallo, profesor i shkencave politike në Universitetin e Bolonjës. Ai kishte rëndësi në kohën kur Meloni dhe shoqëruesit e saj ishin të rinj, dhe pjesa e tyre e së djathtës ishte e përjashtuar nga politika tradicionale për shkak të bagazhit të “referencave kulturore fashiste, të cilat nuk mund t’i shprehnin” publikisht. Pra, fantazia si një filozofi reaksionare e pranueshme për publikun? Pa dyshim, shumë tema të këtij kodi letrar duket se përputhen me këtë përshkrim. Për shembull, është e lehtë të kuptosh se si hierarkia shoqërore mesjetare dhe kategorizimi esencial racor – të zakonshëm në botët fantastike – mund të nxisin pikëpamjet reaksionare. Gjithashtu, është e lehtë të shihet tërheqja ndaj traditës dhe ritualit nga ata që e ndajnë veten të përjashtuar nga moderniteti. (Vassallo thotë se dashuria e Melonit dhe e të tjerëve për Tolkienin ishte “në

përputhje me atë që ata mendonin për veten: njerëz ‘të pastër’ që luftonin për vlerat që i çmonin, por që të tjerët përreth i nënvlerësonin.”) Por, disa nga këto vlerësime janë të padrejta. Në fund të fundit, shumë vepra të letërsisë fantastike mund të interpretohen ndryshe: heronjtë sfidojnë hierarkitë shoqërore; bashkëpunimi ndërmjet racave të ndryshme mposht të keqen. Një mospëlqim i supozuar estetik ndaj modernitetit nuk gjen vend në optimizmin teknologjik të Luginës së Silikonit. Çelësi, mendoj unë, gjendet më shumë te mënyra se si letërsia fantastike ka prirjen drejt heroikes. Këto janë rrëfime të këmbënguljes personale përballë fatkeqësisë maniheike [sipas dualizmit të maniheizmit, religjionit ku bota shihet si një fushëbetejë midis forcave kundërshtarë të dritës dhe errësirës, të së mirës dhe të keqes]. Janë histori ku virtyti fiton; ku individët – nëse marrin vendimet e duhura, përqafojnë vlerat e duhura, ndjekin instinktet e duhura – ia dalin të mundin sistemin. Janë, mund të thuash, rrëfime për triumfin e vullnetit. Kjo përputhet mirë me populizmin. Ajo mbështet idenë se problemet në jetën e njerëzve shkaktohen nga forcat dashakeqe, dhe se disa

individë të veçantë mund t’i përballojnë dhe t’i mposhtin ata armiq. Të dyja këto ide qëndrojnë në themel të retorikës që populistët përdorin për të justifikuar pse njerëzit (hiç më pak se “populli”) duhet të votojnë për ta. “Unë jam hakmarrja juaj”, ka thënë Donald Trump. Populizmi mund të jetë i djathtë ose i majtë. Por, në një mënyrë tjetër, triumfi i vullnetit që përshkon zhanrin fantastik është (siç i përshtatet vetë termit) më i lehtë për populistët e djathtë që ta përvetësojnë. Ai shndërrohet në një frikë nga të qenit i kontrolluar nga strukturat anonime të shoqërisë dhe në një dëshirë që zgjedhjet dhe vlerat tona personale të përcaktojnë botën përreth nesh. Ai pasqyron një dëshirë për kontroll, pushtet dhe për një mekanizëm të qartë që lidh zgjedhjen individuale me ndikimin shoqëror – një dëshirë, në thelb, për një botë epike, jo për atë moderne. Fantazia përfaqëson jo aq një rikthim në një idil paramodern, sesa një përmbushje të lirisë që iluminizmi premtoi, por që kompleksiteti shoqëror ia mohoi individit. Kjo është më e vështirë për të majtën për ta përqaftuar, pasi struktura shoqërore është thelbësore për botëkuptimin e saj. Në nivel personal, ekzistencialistët e majtë mund të dëshiro-

jnë të çlirohen nga pritshmëritë shoqërore. Por, politikisht, e majta e pranon rëndësinë parësore të strukturës shoqërore dhe përpiqet ta formësojë atë, ndërsa e djathta synon ta lërë ashtu siç është (në versionet reaksionare), ose ta shkatërrojë (në ato më libertariane). Ato ëndrra të pastra të djathta janë të destinuara të dështojnë. Ne jetojmë në modernitet, pavarësisht nëse na pëlqen apo jo; shoqëria, pashmangshmërisht, i strukturon zgjedhjet tona. Por, a është për t’u habitur që zhgënjimi që lind nga kjo përvojë nxit një dëshirë për unaza dhe amulete magjike – ose për teknologji të fuqishme, por të vështira për t’u kuptuar? Megjithatë, nga letërsia fantastike mund të nxirret edhe një mësim tjetër. Një strukturë e thellë që lidh njerëzit me natyrën shfaqet, për shembull, në serinë Tokëdeti të Ursula Le Guinit. Këto janë vepra për kufijtë e asaj që fuqia individuale mund të arrijë dhe për mënyrën se si ajo duhet të përdoret për të rikthyer ekuilibrin dhe për të përforcuar strukturat, e jo për t’i shembur ato. Ndoshta Giorgia, Peter, JD dhe miqtë e tyre duhet të lexojnë më shumë letërsi fantastike, jo më pak. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Bardhi arrin marrëveshje me Rizesporin

Pas largimit nga Bodrumspori, Enis Bardhi menjëherë ka gjetur ekip të ri në Superligën e Turqisë. Bardhi u largua nga

Bodrumspori pas rënies nga elita e futbollit turk duke e shkëputur kontratën. Megjithatë, Bardhi edhe sezonin e ri do të luajë në Superligën

turke pasi do të jetë pjesë e skuadrës së Rizesporit. Bëhet me dije se Bardhi ka tashmë marrëveshje me Rizesporin, e cila do të bëhet zyrtare gjatë

kësaj jave. 30-vjeçari bën karrierë në Turqi prej vitit 2022, fillimisht te Trabzonspori dhe pastaj te Bodrumspori, kurse ka luajtur edhe te Levante

në Spanjë e Ujpesti në Hungari. Në 88 ndeshje të luajtura në kampionatin turk, Bardhi ka shënuar 14 gola dhe ka bërë tetë asistime.

Batatina: Do të luftojmë për çdo trofe

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 KORRIK - Skuadra e Llapit ka nisur përgatitjet për sezonin e ri futbollistik 2025/2026, derisa grumbullimin e parë e ka pasur në stadiumin "Zahir Pajaziti". Trajneri i kësaj skuadre, Tahir Batatina, është shprehur i kënaqur me energjinë që e ka parë në ekip, derisa ka shprehur optimizëm se me transferet e reja do të ketë një kampionat të suksesshëm. "Jam shumë i kënaqur me rikthimin në punë dhe me energjinë që e pashë në ekip. Grupi është shumë i mirë dhe transferet e reja do të na ndihmojnë jashtëzakonisht shumë në edicionin e ri. Çdo fillim sjell freski dhe motiv të ri, por këtë herë është diçka më tepër sepse para vetes kemi përgjegjësi dhe synim të madh. Po punojmë me përkushtim maksimal që të krijojmë një grup të fortë dhe të disiplinuar taktikisht", ka thënë Batatina, i cili më pas ka bërë me dije se do të kenë një fazë intensive në mënyrë që skuadra të përgatitet sa më mirë. "Është shumë e rëndësishme që përgatitjet të shfrytëzohen në mënyrën më të mirë të mundshme, andaj kemi planifikuar një fazë intensive për ta ngritur nivelin fizik, teknik dhe psikologjik të skuadrës", ka deklaruar ai.



Llapi në sezonin e fundit arriti ta sigurojë mbetjen në Superligë vetëm nëpërmjet ndeshjes së barazhit, kurse në finale të Kupës së Kosovës pësoi humbje nga skuadra e Prishtinës dhe në këtë mënyrë e mbylli një sezon pa arritur ndonjë sukses të madh. Ndërsa në sezonin e ri kjo skuadër po synon të luftojë për të gjithë trofetë. "Objektivi ynë është të luftojmë për çdo trofe dhe të

paraqitemi denjësisht në secilën ndeshje. Tifozët tanë 'Legjendat', por edhe qyteti i Podujevës, meritojnë më të mirën dhe do të mundohemi që bashkërisht të punojmë për suksesin", ka deklaruar Batatina. Llapi ka bërë ndryshime të shumta në radhët e futbollistëve duke bërë transferime të shumta, por edhe largime të futbollistëve.

SHKURT

Jashari shumë afër transferimit në Milan

Agjenti i Ardon Jasharit ka arritur marrëveshje personale me Milanin për një kontratë pesëvjeçare, me një pagë prej 2.8 milionë eurosh neto në sezon. Tani drejtori sportiv Igli Tare është në bisedime me Club Brugge për ta gjetur marrëveshjen përfundimtare me klubin belg, i njohur për qëndrimin e tij të fortë në negociata, ashtu siç ndodhi me transferimin e Charles De Ketelaere në verën e vitit 2022. Milani ka përmirësuar ofertën dhe ka propozuar 33 milionë euro plus 5 milionë euro bonuse, shumë që është shumë pranë kërkesës së Brugges, që llogaritet në rreth 35 milionë euro plus bonuse. Klubi belg, megjithatë, nuk ka lëshuar ende dhe nuk duket i gatshëm për ulje të menjëhershme. Borussia Dortmundi është përfshirë në garë, por kjo nuk shqetëson Milanin, që ka siguruar pëlqimin personal të lojtarit. Brugge shpresonte të nxiste një ankand për Jasharin, por duket se kjo nuk do të ndodhë. Tare ka synimin që ta mbyllë sa më shpejt marrëveshjen pa e zvarritur më tej.

Interi i shtohet garës për Gjimshitin

Pas Milanit edhe skuadra e Interit është futur në garë për shërbimet e Berat Gjimshitit, kanë njoftuar të mërkurën mediet italiane. Profili i Gjimshitit po pëlqehet nga trajneri i Interit, Christian Chivu, i cili në këtë afat kalimtar po kërkon transferimin e një mbrojtësi me përvojë. Chivu është i bindur se Gjimshiti do të ishte ideal për mbrojtjen e Interit, duke pasur parasysh se e njeh mirë kampionatin italian dhe është një prej lojtarëve kyç tek Atalanta. 32-vjeçari ka kontratë me Atalantan deri në vitin e ardhshëm, ndërsa kartoni i tij vlerësohet rreth 10 milionë euro. Interi është i gatshëm të paguajë një shifër të tillë, si dhe t'i ofrojë Gjimshitit pagë vjetore prej një milion eurosh nëse arrin marrëveshje me Atalantan. Krahas dy ekipeve italiane, Gjimshiti po kërkohet edhe në Emiratet e Bashkuara Arabe.

Trepça mëson kundërshtarët në kualifikimet e Ligës së Kampionëve

MITROVICË, 2 KORRIK - Kampionia e Kosovës, Trepça, ka mësuar kundërshtarët në kualifikimet e Ligës së Kampionëve në basketboll. Sfida e parë do të jetë ndaj skuadrës së njohur holandeze Heroes Den Bosch. Nëse kampionët e Kosovës e kalojnë këtë pengesë, atëherë në gjysmëfinale do të përballen me fituesin e ndeshjes Bakken Bears (Danimarkë) dhe BC Kutaisi 2010

(Gjeorgji). Njëzet e katër (24) ekipe do të garojnë në tre (3) turne të raundit kualifikues. Të tre turnetë e raundit kualifikues do të zhvillohen në fund të shtatorit. Orari i ndeshjeve, si dhe vendi i zhvillimit, do të shpallen më vonë në korrik. "E kemi mësuar rrugën tonë, jemi gati për sfidën! Në ndeshjen hapëse do të përballemi me ekipin historik nga Holanda, Heroes Den Bosch. Një sfidë e fortë, por ne nuk jemi këtu

për t'u frikësuar, jemi këtu për të luftuar. Nëse e kalojmë këtë pengesë, në gjysmëfinale do të përballemi me fituesin mes Bakken Bears (Danimarkë) dhe BC Kutaisi 2010 (Gjeorgji). Çdo sfidë është e vështirë, por ne besojmë në veten tonë, në fanellën që mbajmë dhe në tifozët tanë që janë forca jonë më e madhe. Ne jemi Trepça dhe nuk dorëzohemi kurrë!", thuhet në njoftimin e Trepçës.



Verstappenin pran kalimit te Mercedesi

BRACKLEY, 2 KORRIK - Piloti Max Verstappen është afër një marrëveshjeje me Mercedesin për vitin 2026. Sipas "Sky Sport", negociatat janë tashmë në një fazë të avancuar midis holandezit, katër herë kampion bote në Formula 1 dhe ekipit britanik. Makina gjermane

synon të kthehet në majë duke filluar nga sezoni i ardhshëm dhe për këtë kërkon ndihmën e Verstappenit. Ai do ta kishte Kimi Antonellin shok skuadre, i mbrojturi i Toto Wolff, ndërsa George Russell do të largohej pas katër sezonesh. Sigurisht ka çështje

komplekse kontraktuale për t'u zgjidhur, duke pasur parasysh se Maxi ka një kontratë me Red Bullin të vlefshme deri në fund të vitit 2028. Javët e fundit është folur për një klauzolë që piloti mund ta aktivizojë nëse nuk është midis tre të parëve në renditjen e kampionatit

botëror në pjesën e parë të sezonit. Ai aktualisht është i treti me një avantazh prej 9 pikësh ndaj Russellit (i katërti), por është e qartë se vullneti i pilotit është ai që do të bëjë diferencën. Nëse superlëvizja do të ketë sukses, mbetet të shihet se cili mund të jetë fati i Russellit, pasi



kontrata e tij do të skadojë në fund të sezonit.

Gjyqtarja e basketbollit, Erisa Ibrahim, vlerësohet me titullin "Ambasadore për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut"

MITROVICË, 2 KORRIK - Ish-basketbollistja, tani gjyqtare e basketbollit, Erisa Ibrahim, është vlerësuar me titullin Ambasadore për Paqe dhe të Drejtat e Njeriut, si njohje për kontributin në sport - në veçanti si gjyqtare e basketbollit dhe si edukatore sportive në shkollën amerikane në Mitrovicë. "Ky çmim më është dhënë nga Tahir Shabani, ambasador i njohur ndërkombëtar për paqe dhe të drejtat e njeriut. Jam e nderuar që përmes këtij vlerësimi përfaqësoj jo vetëm sportin tonë, por edhe vlerat e paqes dhe të drejtave të njeriut. Shpresoj që ky çmim të shërbejë si një nxitje për bashkëpunim të mëtejshëm dhe për vlerësimin e punës që bëjmë përmes sportit si mjet edukues dhe bashkues", është shprehur Ibrahim për faqen zyrtare të FBK-së. "Të jem përzgjedhur Ambasadore për Paqe dhe për të Drejtat e Njeriut është një nder i veçantë dhe një angazhim i thellë", theksoi ish-basketbollistja e grupmoshave të Kosovës. "Si mësuese e edukatës fizike, gjyqtare e basketbollit dhe ish-basketbolliste, kam pasur mundësinë dhe vazhdoj të



ndikoj në jetët e të rinjve duke përdorur sportin jo vetëm si mjet fizik, por edhe si platformë për edukim, barazi dhe bashkëjetesë. Sporti më ka formuar si njeri, më ka mësuar rregull, respekt, disiplinë dhe drejtësi - vlera që përqipim t'i përçoj çdo ditë në punën dhe jetën time. Ky emërim më jep një përgjegjësi edhe më të madhe për të qenë zë i qartë për të

drejtat e njeriut, për paqen dhe për fuqizimin e rinisë. E shoh këtë rol si një mundësi për të kontribuar më shumë në ndërtimin e një shoqërie ku secili ndihet i barabartë, i respektuar dhe i mbështetur. Faleminderit për besimin që më është dhënë. Do të jem gjithmonë në shërbim të vlerave që e bëjnë një komunitet të fortë dhe të drejtë", përfundoi Erisa Ibrahim.

Publikohet lista e hendbollisteve të Kosovës U19 në hendboll

PRISHTINË, 2 KORRIK - Selektori i Kosovës në hendboll, Agron Shabani, të mërkurën ka publikuar listën e lojtareve të Kombëtares U19 të Kosovës. Bëhet fjalë për gjeneratën që vjet u paraqit në Kampionatin Botëror U18 të mbajtur në Kinë. Shumica e lojtareve të ftuara ishin në Botëror, kështu që ato kanë përvojën e ngjarjeve ndërkombëtare. Ka mungesa të rëndësishme, por vajzat e përzgjedhura do ta japin maksimumin për prezantim të dinjitetshëm. Faza përgatitore do të shfrytëzohet maksimalisht,



ndërsa planifikohen edhe ndeshje kontrolluese. Kombëtarja U19 do të grumbullohet të shtunën, më 5 korrik, në Istog, ndërsa vajzat tona do të përgatiten nën urdhrat e

selektorit Shabani për Kampionatin Evropian (B). Evropiani mbahet në Telavi të Gjeorgjisë prej 12 deri më 20 korrik. Ndeshjen e parë vajzat tona e kanë më 12 korrik ndaj Bullgarisë. Më pas luajnë me Ukrainën, Sllovakinë dhe Gjeorgjinë. Lista: Albina Pllana, Elisa Krasniqi, Orgesa Gola, Arona Krasniqi, Martina Bibaj, Sara Gjeggaj, Alina Shabani, Aulona Maloku, Elona Zeneli, Klaudia Ukaj, Laura Maqedonci, Zoja Kameraj, Diona Dresh, Sara Kameraj, Arjeta Imeraj, Lejla Hyseni.

SHKURT

Lecce, gati ta shesë Ramadanin

Mesfushori Ylber Ramadani mund të largohet këtë verë nga skuadra e Lecces nëse e kërkon një gjë të tillë. Kështu ka insistuar drejtori i ekipit italian, Panteleo Corvino, që ishte i pranishëm në konferencën për shtyp gjatë prezantimit të trajnerit të ri, Eusebio Di Francesco. Drejtori Corvino ka thënë se nëse disa prej lojtarëve kryesorë, në mesin e tyre edhe Ramadani, do ta kërkojnë largimin, atëherë nuk do t'i pengojnë. Madje, sipas tij, ky sezon ka qenë cikli i fundit për shumë lojtarë te Lecce dhe për këtë arsye klubi do t'i dëgjojë të gjitha kërkesat e atyre që duan të largohen. Së fundmi, Ramadani ka marrë një ofertë nga klubi saudit Al-Ain, që i ka ofruar kontratë trevjeçare me pagë vjetore mbi një milion euro. 29-vjeçari ka kontratë me Leccen deri në verën e ardhshme, ndërsa kartonin e tij te skuadra italiane e vlerësojnë prej 7 deri në 10 milionë euro. Në 29 ndeshje të luajtura sezonin e fundit në Serinë A, Ramadani ka shënuar 1 gol dhe ka bërë 1 asistim.

Mësohen datat kur do të zhvillohen 'El Clasico'-t

La Liga e ka publikuar orarin e ri për sezonin e ri. Një nga derbit kryesor në botën e futbollit është "El Clasico", e cila zgjon interesim tepër të madh te futbolldashësit. Tashmë dihen edhe datat se kur do të përballen mes vete Real Madridi dhe Barcelona. Loja e parë në edicionin 2025/2026 do të luhet më 25 ose 26 tetor 2025 në "Santiago Bernabeu" si dhe ndeshja kthyese në "Camp Nou" do të zhvillohet më 9 ose 10 maj 2026.

Jarell Quansah, lojtar i ri i Bayer Leverkusenis

Bayer Leverkuseni ka konfirmuar edhe zyrtarisht transferimin e mbrojtësit Jarell Quansah nga Liverpooli. Klubi gjerman ka njoftuar të mërkurën gjatë ditës se ka kompletuar transferimin e mbrojtësit të ri anglez. I diplomuari i akademisë së Liverpoolit ka nënshkruar një kontratë afatgjatë me skuadrën e Bundesligës. "Bayer 04 Leverkusen ka nënshkruar me lojtarin reprezentues të Anglisë U21 dhe kampion të Evropës, Jarell Quansah. Mbrojtësi qendror i bashkohet klubit të Bundesligës nga kampionët anglezë Liverpool FC, ku ai nënshkroi një kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2030", thuhet në njoftim. Thuhet se Leverkuseni ka rënë dakord ta paguajë një tarifë fillestare prej 30 milionë eurosh plus deri në 5 milionë euro në bonuse.

Alonso pas kualifikimit: Jemi të kënaqur

Botërori i Klubeve ishte një test i fortë për Xabi Alonso, por tekniku spanjoll nuk zhgënjën në këto hapa të parë në krye të Real Madridit, arrin të sigurojë

një biletë për në fazën çerekfinale. Alonso u shfaq i kënaqur pas takimit kundër Juventusit, jo vetëm për faktin që kaluan më tej në këtë turne. "Jemi të kënaqur

me këtë rezultat, me paraqitjen e ekipit dhe për faktin që kaloi këtë turn. Në 15 minutat e para hasëm vështirësi, por më pas morëm masa. Ne e dinim që kundër

Juves do të ishte e vështirë, por në fund jam i lumtur. Dyshja Garcia - Mbappe? Gonzao ka instinktin e një sulmuesi, është gjithnjë në momentin e duhur, në

vendin e duhur, ka qenë perfekt. Mbappe nuk ishte 100 %, por do të ketë kohë të rikuperohet. Për ne ai është shumë i rëndësishëm", u shpreh Alonso.



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpimë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegijibiznesi.com,
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegijibiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të regullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse në studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor

- 1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)
- 2.Menaxhment dhe Ekonomikë (Ba) - (3 Vjeçar)
- 3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)
- 4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)
5. Shkencë Kompiuterike Bsc - (3 Vjeçar)

Studime Master

- 1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
- 2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555
044/ 049/ 043- 500 – 878



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpimë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegijibiznesi.com, info@kolegijibiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. Dy (2) mësimdhënës në programin – **Ekonomik**,
2. Dy (2) mësimdhënës në programin – **Juridik**,
3. Dy (2) mësimdhënës në programin – **Menaxhimi i Emergjencave**,
4. Një (1) mësimdhënës në programin – **Shkencë Kompiuterike**,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatës dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohtja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025**.

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegijibiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegijibiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në web faqen: www.kolegijibiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Ariani Home" SH.P.K. me nr. Unik Identifikues: 811926271 Vushtrri, shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330596984.

-Hyrije Fejza B.I. shpall te pavlefshme arkën fiskale me nr. unik: 811281790.

- Shemsie Lahu shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ismail Qemali".

- Jeton Xhafiqi shpall të pavlefshme patentë shoferin (lejen e kerrit) Piranë Prizren.

- Aleksandar Mihajlovic shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 81070307.

- Kujtim Zeneli shpall te pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të gjimnazit "Frang Bardhi".

- Lule Osmani shpall të pavlefshme diplomën e sh.m, të Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

